

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Monumenteve, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë dhe Njësinë Bazë të Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë, organizoi një aktivitet në Parkun Kombëtar Arkeologjik të Antigonesë.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte ndërgjegjësimi mbi vlerësimin dhe rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe monumenteve historike, si dhe njohja e të rinjve me objektet e trashëgimisë kulturore.

Në këtë aktivitet morën pjesë specialistë të DRTK Gjirokastrë, pedagogë dhe studentë të programit Bachelor të kësaj njësie, si dhe të programit 2-Vjeçar "Udhërrëfyes turistik", të cilët ishin pjesë e diskutimeve dhe aktiviteteve ndërgjegjëse, me fokus vlerësimin, njohjen e monumenteve dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

